

Në bazë të nenit 10 paragrafi (1) dhe paragrafi (6) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 20-të mbajtur më 02.05.2024, në lidhje me Propozimin nr.03-2168/1 datë 02.05.2024, për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër SHTR Alfa TV SHPKNJP Shkup për shkelje të nenit 75-gj paragrafi (1) të Kodit Zgjedhor, miratoi si vijon:

### **KONKLuzion**

1. Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer (monitorim) mbi përfaqësimin mediatik zgjedhor nr.10-2162/1 datë 02.05.2024 të SHTR Alfa TV SHPKNJP Shkup, përcaktoi shkelje të nenit 75-gj paragrafi (1) të Kodit Zgjedhor.

2. Këshilli konkludoi kundër SHTR Alfa TV SHPKNJP Shkup të inicioi procedurë për kundërvajtje para gjykatës kompetente, sepse nga mbikëqyrja u konstatua se në kundërshtim me nenin 75-gj paragrafi (1) të Kodit Zgjedhor, më datë 25 prill 2024 gjatë kohës së rrethit të dytë të Zgjedhjeve presidenciale 2024, në orët reale të programit të transmetuar nga ora 8 deri në ora 9, nga ora 9 deri në ora 10, nga ora 10 deri në ora 11, nga ora 11 deri në ora 12, dhe nga ora 12 deri në ora 13, ka transmetuar më shumë se 4 minuta reklamim politik me pagesë për kandidaten për kryetar – Gordana Siljanovska Davkova, mbështetur nga partia politike në opozitë VMRO-DPMNE.

3. Detyrohet Sektori për çështje juridike të përgatisë Kërkesën për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

4. Kopje e Konkluzionit t'i dorëzohet:

- Udhëheqësve të gjithë sektorëve të Agjencisë;
- Personit të emëruar nga Agjencia, për udhëheqjen e lëndës sipas procedurës administrative;
- Njesisë për mbështetjen e punës së Këshillit të Agjencisë;
- Sektorit për mbështetje informative dhe punëve të përgjithëshme – Arkivi i Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**